


TRIBUNA SINDIKALE

Prill 2007

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë



Editorial**DOMOSDOSHMERIA E KONTRATES KOLEKTIVE NE ARSIMIN PRIVAT**

Ministria e Arsimit dhe Shkences, ne bashkepunim me Sindikatat e Arsimit, si partnere sociale, dhe grupe te tjera te interesit po punojne ne menyre intensive per hartimin e Strategjise se plote te sistemit te arsimit parauniversitar ne Shqiperi.

Ne Strategjine e Arsimit Parauniversitar qe po hartohet do te perfshihen edhe arsini parashkollor, arsini i mesem profesional ne nje kuader shume me te gjere, me te plote dhe me bashkekohor se ai qe pëmban Strategjia ekzistuese, si dhe arsini privat.

Sindikatat e Arsimit, FSASH e SPASH, partnere te MASH, jane pjesemarrrese aktive ne gjithë procesin e diskutimeve dhe hartimit te Strategjise se Arsimit Parauniversitar.

Por, ne gaten e gjere te problematikes qe duhet te pëmbaje kjo Strategji, si nje problem i madh kombetar ne vendin tone, arsini privat ze nje vend me rëndesi.

Pa përmendur arsimin e larte, qe nuk eshte synim i kesaj trajtесе, arsini privat, perfshire ate parashkollor, 9-vjecar, te mesem te pergjithshem dhe profesional, nga viti ne vit ka marre dhe po marre nje shtrirje te gjere. Aktualisht, ne keto nivele te arsimit parauniversitar numri i mesuesve te angazhuar ne arsimin privat eshte rreth 7 perqind ne raport me numrin e pergjithshem te mesuesve ne shkalle vendi. Pra jane rreth 3.000 mesues dhe edukatore kopshti te punesuar ne kete sektor. Kjo perben nje force te madhe e te kualifikuar intelektuale qe luan rol te rëndesishem ne formimin dhe arsimimin e brezit te ri.

Ishte nje periudhe, sidomos para 2-3 vitesh, kur pagat ne arsimin parauniversitar publik ishin tepër te uleta, qe terhoqi shume mesues te kualifikuar nga arsini publik dhe i perfshiu ata ne shkollat private. Ne ato kushte, paga si motivimi kryesor, i bente shume nga keta mesues qe te kalonin krejt ne plan te dyte, bile edhe te injeronin kerkesa te tilla si koha e punes, kushtet e punes dhe nbi te gjitha mungesen e nje kontrate individuale dhe kolektive te punes, qe u garanton atyre standardet ligjore te punesimit, mungese qe ne raste te caktuara, jo te pakta, eshte fatale per punemarrësin, sepse ai nuk gëzon mbrojtjen e nevojshme ligjore.

Tani eshte momenti qe ky boshllëk te

plotësohet. Dhe kjo eshte nje nga detyrat paresore te Sindikatave Qendrore te Arsimit. Jane sindikatat ato qe duhet t'i ndihmojne mesuesit dhe t'u ofrojne atyre qe dëshirojne, ndihmen per te ndertuar keto marrëdhënie nbi baza institucionale e ligjore. Kjo kerkon qe ata te njihen me kete kuader ligjor te marrëdhënieve te punes, te njihen me mundesite qe u ofrojne sindikatat per t'i ndertuar e zbatuar keto marrëdhënie sipas normave te nje shteti ligjor. Kuptohet se per te mundesuar plotësimin e ketyre standardeve, per te mbrojtur veten e tyre, kerkesat e tyre ekonomike dhe sociale, mesuesit dhe gjithë te punesuarit e tjere ne arsimin privat duhet te anetareschen ne sindikate. Mbi baza plotësisht vullnetare dhe te vetdijshem per nevojën e nje mbrojtjeje sociale reale, ashtu sic veprohohet sot ne te gjithë boten e qytetuar dhe ne ekonomine e tregut, ata duhet te krijojne dhe te bashkohen ne sindikaten e tyre. Ata duhet te ndërgjegjsohen se vetem te bashkuar ne keshillat e tyre sindikale, ne seksionet sindikale dhe ne kuadrin e sindikatave kombetare mund t'i mbrojne kerkesat dhe interesat e tyre te punes.

Detyre e sindikatave ne baze rrethi e qarku eshte qe t'u qendrojne me afer ketyre mesuesve, t'u japin ndihmen e nevojshme te kualifikuar per te negociuar me punëdhësin, per te zhvilluar nje dialog social real dhe te efektshem qe marre parasysh interesat e shkolles e te nxënësve qe arsimohen ne keto shkolla ne radhe te pare dhe pastaj interesat e punemarrësve dhe te punëdhënësve, qe medoemos duhet te ndertohen e harmonizohen nbi bazen e kuadrit ligjor te marrëdhënieve te punes. Te gjitha keto do te gjejne shprehje ne nje Kontrate Kolektive dinjitoze, qe eshte pjese e ketij kuadri ligjor te marrëdhënieve te punes.

FSASH dhe SPASH do te angazhohen me gjithë mundesite e tyre ne kete proces, me bindjen se plotësimi i ketij boshllëku nuk eshte thjeshte nje synim sindikal, por nje objektiv dhe zgjidhje ne shërbim te nje strategjie solide qe nenkupton cilesi te larte, shanse te barabarta dhe nivele bashkekohore ne arsimin parauniversitar ne vendin tone.

PERMBAJTJA

| | |
|---|----|
| <i>Editorial:</i> | |
| ✓ Domosdoshmeria e Kontrates Kolektive ne arsimin privat | 2 |
| Java e Veprimeve Globale për | |
| ✓ Arsimin 2007, (23-29 prill) | 3 |
| Perkujtohet 16 vjetori i SPASH-it | 5 |
| ✓ Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH-it | 6 |
| ✓ Nga mbledhja e KD i FSASH | 7 |
| ✓ Leter e FSASH-it drejtuar Ministrit te Arsimit dhe Shkences | 11 |
| ✓ Nga aktivitetet ne shkollat e Tiranës me rastin e 7 Marsit | 12 |
| ✓ Perkujtohet 40 vjetori i Gazetes "Studenti" | 13 |
| ✓ Krijohet Keshilli i Sindikatave Globale | 14 |
| Te reja shkencore dhe keshilla | |
| ✓ praktike | 15 |

Kopertina e pare:

Nga ceremonia e perkujtimit te 16 vjetorit te SPASH-it.

Kopertina e fundit:

Fotografia i ben thirrje gjithë shoqerise per te eliminuar punen e femijeve

TRIBUNA SINDIKALE**Nr. 26, Periodike**

*Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare"
Pallati Ali Kelmendi, kati III,*

Tel: 22 83 46

Tel & Fax: 25 65 32

E-mail: fsash@icc-al.org

Keshilli Botues:

Xhafer Dobrusha,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor



Java e Veprimeve Globale për Arsimin 2007, (23-29 prill)

“Bashkohuni për të plotësuar të drejtat për arsimim menjehere, tani”

Si çdo vit, edhe sivjet sindikatat e arsimit dhe disa shoqata dhe organizma të tjera të angazhuara në fushën e arsimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve do të organizojnë, gjatë ditëve të javës së fundit të prillit, (23-29 prill), Javën e Veprimeve Globale për Arsimin.

Federata Ndërkombëtare e Arsimit, (EI), dhe organizatat e saj anëtare në të gjithë botën, vazhdojnë të luajnë një rol drejtues në Javën e Veprimeve Globale për të rritur presionin mbi qeveritë, për të treguar në shumë aftësi drejtuese, për të siguruar që të gjithë fëmijët të kenë mundësinë të marrin mësim nga nësues të kualifikuar.

Java e Veprimeve Globale ka për qëllim të mobilizojë opinionin publik për të ushtruar presion mbi qeveritë dhe agjensitë bashkëqeverisëse për të siguruar arsim publik cilësor dhe falas për të gjithë. Ajo organizohet çdo vit, në të njëjtën periudhë, për të risjellë angazhimin e bërë nga 180 qeveri në Forumin Botëror të Arsimit në prill 2000 në kontekstin e Qëllimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, (MDG), të Kombeve të Bashkuara.

Sivjet do të jetë viti i tetë i organizimit të Javës së Veprimeve Globale në të cilën EI, së bashku me partnerin e saj, Fushatën Globale për Arsimin, (GCE), do të kërkojë të drejtën për arsimim për miliona fëmijë në të gjithë botën që aktualisht janë të përjashtuar nga

arsimimi.

Tema e aktiviteteve të kësaj Jave për këtë vit është: “Arsimimi si një e drejtë njerëzore”, prandaj mesazhi i përgjithshëm i veprimtarive të kësaj jave do të jetë domosdoshmëria e arsimit për të gjithë, sepse kjo është një e drejtë njerëzore.

Me gjithë pëmirësimet e bëra, edhe sot, ne të gjithë gldoin, akoma në shumë se 80 milion fëmijë zgjohen çdo ditë pa shpresën që të ofrojnë arsimimi. Çdo ditë që këtyre njerëzve u mohohet arsimimi i lë ata në injorancë dhe varfëri.

Neve tani na duhet Arsimim Për të Gjithë, (EFA), për t'i dhënë fund këtij skandal.

Qëllimet e EFA-s të Pranuarra në Dakar-Senegal në vitin 2000

1) Zgjerim dhe pëmirësim tërësor të kujtesit dhe arsimit në fëmijërinë e hershme, veçanërisht për fëmijët në të prekshëm dhe në disavantazh.

2) Sigurim që deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët, veçanërisht vajzat, fëmijët në rrethana të vështira dhe ata që u përkasin minoriteteve etnike, të kenë akses në një arsimim fillor falas, të detyrueshëm dhe me cilësi të mirë.

3) Sigurim që nevojat e mësimi të të gjithë të rinjve dhe të rriturve të plotësohen nëpërmjet aksesit të paanshëm në programet e

përshtatshme të mësimi dhe të aftësive në jetë.

4) Arritje e 50 përqind pëmirësim në nivelet e shkollimit e këndimit të të rriturve deri në vitin 2015, veçanërisht për gratë, dhe akses të paanshëm në arsimimin bazë dhe, ne vazhdim, për të gjithë të rriturit.

5) Arritje e barazisë së gjinive në arsim deri në vitin 2015, duke u fokusuar në sigurim aksesit të plotë dhe të barabartë në të për vajzat dhe arritje të arsimit bazë cilësor.

6) Pëmirësim i të gjithë aspekteve të arsimit cilësor dhe sigurim përsosmërie për të gjithë, në mënyrë që rezultatet e njohura dhe të matura të mësimi të arrihen nga të gjithë, veçanërisht në shkrim e këndim, matematikë dhe aftësitë thelbësore në jetë.

Pse këtë vit fokusohemi tek e drejta për t'u arsimuar?

Viti 2007 është thelbësor, si viti në mes të rrugës për të arritur synimet e EFA (arsimim për të gjithë, deri në vitin 2015). Koha për arritjen e këtyre synimeve është duke kaluar shumë shpejt. Është një moment që kërkon më shumë veprime urgjente për të arritur të drejtën për arsimim. Me shumë se të qenit një ide e largët për t'u aritur, këto të drejta duhet të

Vijan nga faqja 3

konvertohen në një realitet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe për këtë synimet e EFA përcaktojnë një afat. Fokusimi në "Arsimimi si një e drejtë njerëzore" çon në organizimin e Fushates për të promovuar gjithë axhendën e EFA.

Kjo bëhet akoma më imperative edhe për faktin se, fatkeqsisht, bota vazhdon të mbetet jashtë ruge për të arritur edhe objektivat minimale të pranuar në MDG. 80 milion fëmijë nuk frekuentojnë shkollën; 60 % të cilëve janë vajza. Sipas përqindjeve aktuale të zhvillimit, rreth 86 vendë janë jashtë ruge në arritjen e objektivit të dhënies të gjithë fëmijëve një edukim 9-vjeçar të plotë deri në vitin 2015. Dhe tabloja është edhe më e zymtë kur situata analizohet në bazë rajonale. Sipas përqindjeve aktuale të zhvillimit, Afrika nuk do të mund të ketë sukses deri në vitin 2150. Situata bëhet akoma më e komplikuar po t'u referohemi të miturve të pa arsimuar, të cilët kapin një shifër prej rreth 1 miliard në të gjithë botën.

Mesazhi bazë i Javës së Veprimeve Globale këtë vit do të jetë:

- Arsimimi ka të bëjë me një të drejtë bazë e të përhershme njerëzore
 - 2007 është pika mesit të afatit për realizimin e Synimeve të Mijëvjeçarit për Arsimim për të Gjithë, EFA, dhe, me gjendjen aktuale të progresit, këto synime nuk prentojnë për t'u realizuar.
 - Akoma 80 milion fëmijë nuk kanë mundësi të shkojnë në shkollë dhe rreth 1 miliard të mitur janë analfabetë.
 - Çfarë po mendoni të bëni ju si drejtues në lidhje me këtë gjendje TANI, sa nuk është vonë?
- Përvoja e organizimit të Javës së Veprimeve Globale në vitet që kanë kaluar ka treguar se, nëse do të jemi të bashkuar dhe do të flasim me një zë,

ne mund të kemi një ndikim të fuqishëm dhe mund t'i detyrojmë qeveritarët tanë që të ndërmarrin veprime përpara se të jetë shumë vonë.

Pjesëmarrësit në këto Fushata duhet të frymëzohen nga progresi që është bërë gjatë këtyre viteve të fundit në këtë drejtim.

Një rekord prej 2 milion njerëz morën pjesë në aktivitetet e kësaj Jave në vitin 2003, të titulluar: "Arsimimi i Vajzave: leksioni në i madh".

Më shumë se 2 milion e gjysëm pjesëmarrës u regjistruan në aktivitetet e kësaj jave në vitin 2004, të titulluar: "Lobingu më i madh që ka ndodhur ndonjëherë në botë".

Rreth 5 milion pjesëmarrës u regjistruan në vitin 2005, në aktivitetet e kësaj Jave, të titulluar "Arsimimi që t'i japim fund varfërisë".

Më shumë se 5 milion e gjysëm pjesëmarrës u shënuan në aktivitetet e kësaj jave në vitin 2006, nën sloganin: "Çdo fëmijë ka nevojë për një mësues".

Një pjesëmarrje masive pritet në aktivitetet që do të zhvillohen në kuadrin e kësaj Jave këtë vit në gjithë botën, përfshirë edhe vendin tonë.

Çfarë aktivitetesh pritet të zhvillohen nga FSASH e SPASH në vendin tonë?

Si çdo vit, edhe sivjet sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, janë duke u përgatitur të zhvillojnë aktivitete të rëndësishme në kuadrin e kësaj Jave. Ato mbështeten edhe këtë vit nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, e cila vazhdon të jetë shumë aktive për këtë çështje. Duke qenë se në fushën e arsimit dhe të mbrojtjes së fëmijëve janë të angazhuara edhe disa organizata e institucione të tjera, të cilat janë aktive gjatë ditëve të Javës së Veprimeve Globale, edhe këtë vit vazhdon të funksionojë Kolacioni "Për arsimimin e fëmijëve në Shqipëri", me pjesëmarrjen e Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, (CRCA), dy

sindikatave të arsimit, FSASH e SPASH, World Vision, Save the Children, MEDPAC etj, i cili pordjek nga afër organizimin e shumë aktiviteteve, ndër të cilat mund të përmendim: një Konferencë të përbashkët për shtyp, e cila pritët të zhvillohet në datën 20 prill, një Workshop në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore të rretheve, një takim i përbashkët i FSASH e SPASH, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me pjesëmarrjen e mësuesve e nxënësve nga disa rrethe të vendit, disa takime të seksioneve sindikale të FSASH e SPASH në rrethet kryesore, etj.

Janë përgatitur postera, si edhe një Letër e Hapur drejtuar gjithë parlamentarëve, e cila pritët që të nënshkruhet, së bashku me një letër me disa pretime për çështjet që lidhen me objektivat e Javës së Veprimeve Globale në vendin tonë. Pritet, gjithashtu, që në Parlament të ketë një prononcim në lidhje me domosdoshmerinë e angazhimit të Parlamentit dhe deputeteve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me arsimimin për të gjithë, objekt i Javës së Veprimeve Globale për Arsimin.

Dosje me materiale të shumta që kanë të bëjnë me gjendjen e këtyre problemeve në vendin tonë dhe rekomandimet e Koalicionit në fjalë për përmirësim në këto drejtime do t'u shpërndahen deputeteve dhe përfaqësuesve të shtypit në aktivitetet që do të zhvillohen në kuadrin e kësaj Jave.

Seksionet sindikale në rrethe dhe këshillat sindikale në shkolla, në bashkëpunim me përfaqësuesit e këtyre organizatave dhe Drejtoritë Arsimore në çdo rreth, ashtu si edhe të gjitha shoqatat pjesëmarrëse në Koalicion, do të organizojnë, gjithashtu, aktivitete të rëndësishme në shkolla e në nivele të tjera.

Përgatiti
Stavri LIKO

Per kuj tohet 16 vjetori i SPASH-it

Me daten 30 mars 2007, ne pervjetorin e 16 te te SPASH, ne nje koktej emocionant, u mbledhen perfaqesues te rinje e te vjeter te saj, te cilet perkujtuan ngjarjet kryesore gjate kesaj periudhe 16 vjecare qe nga krijimi i kesaj sindikate.

Ishte Aktivi i Pare i Sindikates se Pavarur te Arsimit, i mbajtur ne daten 28 mars 1991, i cili zgjodhi organet drejtuese, ne kryetar zotin Imir Kanba dhe vuri themelet e partneritetit ne Ministrine e Arsimit

Shkreta, e cila, edhe nepermjet komentit te Flete palosjes se botuar me kete rast, vuri ne dukje veprimtarine e SPASH per mbrojtjen e interesave te anetareve te saj dhe te mesuesve ne pergjithesi.

Jane kate kongrese dhe gjashte kontrata kolektive te nivelit te pare, te shtrira ne 32 rrethe te vendit. Me Aktmarrveshje te posacme, jane ndertuar marrdheniet e bashkepunimit me FSASH, dhe po keshtu te dyja sindikatat tona te arsimit kane ndertuar marrdheniet e

por edhe qonence te forte ndaj Ministrise e Qeverise, gje qe do te vazhdoje edhe ne te ardhmen.

Te pranishmit i persherdeten edhe Presidenti i BSPSH-se, zoti Gezim Kalaja, Perfaqesuesi i MASH, Keshilltari i Ministrit, zoti Ivan Keta, Perfaqesuesi i Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale e Shanseve te Barabarta, zoti Bujar Cani, Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobushi etj.

Gjate ceremonise, ne mer te SPASH-it, per aktiviste te dalluar,



e Shkences, MASH.

Duke marre pjese ne kete Takim, zoti Imir, pasi falenderoi per ftesen, se bashku me sindikalistet e shqar te asaj kohe, si B. Cani, A. Lame, V. Xheneri, H. Daja, D. Spahiu, K. Kruja dhe perfaqesues te 16 rretheve kujtuan momente nga Aktivi i marsit 1991 dhe aktivitetet e tjera te organizuara gjate viteve ne vazhdim.

Fjalen e miresardhjes, ne emer te Kryesise, e mbajti zonja Reihan

bashkepunimit me Sindikaten e Pavarur te Arsimit te Kosoves, SBASHK.

Aktivitetet e SPASH-it u zgjenuan se tepemi, ne anetaresimin e saj ne Federaten Boterore te Arsimit, EIF, ne vitin 1995, duke zgjenuar keshtu edhe marrdheniet e bashkepunimit me sindikatat simotra ne Europe e me gjere e sidomos me sindikatat holandeze AOB dhe FNV.

SPASH ka ndertuar e zbatuar politika bashkepunimi e partneriteti,

u shpermdane Certifikata Mirenjchjeje per kontributin e dhene ne vite ne radhet e SPASH.

Ne fjalen pemylllese te Takimit, Kryetari i SPASH-it, zoti Bajram Kruja falenderoi gjithte pjesemarrsit per kontributin e dhene dhe pjesemarrjen ne kete ceremoni dhe vuri ne dukje angazhimet aktuale dhe ato te pritshme te SPASH per mbrojtjen e interesave te anetareve te saj e te mesuesve shqiptare ne pergjithesi.

Partneriteti Social kerkon angazhim me te mire te gjithë te zgjedhurve

Nga mbledhja e Keshillit Kombëtar të SPASH-it

Ne vijim të aktivitetëve të SPASH-it, u zhvillua pak kohë më parë, mbledhja e Keshillit Kombëtar, e cila mori në analizë punën e bërë dhe detyrat për të ardhmen në lidhje me forcimin e partneritetit social, si edhe zbatimin e kontratave kolektive të nivelit të parë e të dytë.

Në prezencë të anëtarëve të Keshillit dhe drejtuesve të Seksioneve përfshijë nga të gjitha rrethet e vendit, përfshirë edhe rrethet Erseke e Peqin që janë riorganizuar së fundmi, (me përjashtim të rrethëve Gjirrokaster e Mat), raportet në lidhje me këto çështje u mbajtën nga Kryetari Z. Bajram Kruja dhe Zëvendës Kryetari Z. Defrim Spahiu.

Më pas u bënë diskutime të shumta, me ndjenjë të lartë përgjegjësie, mbi problemin që kanë dalë gjatë kësaj periudhe.

Në lidhje me partneritetin social, të gjithë njëzëri paraqitën shqetësimet e tyre për mungesat e dukshme, me përjashtim të rrethëve Korçë e Tiranë Rreth. Kërkesa e përfaqësuesve të seksioneve sindikale të rrethëve ishte që Kryesia e SPASH-ut urgjentisht duhet të bëjë presion ndaj MASH për të paraqitur pranë Keshillit të Ministrave kërkesat tona, sipas Kontrates Kolektive të punës.

Shqetësuesë janë bërë edhe levizjet e drejtuesve dhe mesuesve pa marrë parasysh nën të 5/1-

5/5 dhe 5/7 të Kontrates Kolektive, për të cilat MASH duhet të mbajë qëndrim.

Në lidhje me nënshkrimin e Kontrates Kolektive të nivelit të dytë, nga diskutimet doli se janë nënshkruar tashtëm këto kontrata në 22 rrethë dhe është në procedurë Qyteti i Tiranës. Problemi mbeten rrethet Gjirrokaster, Vlorë, Kuçovë, malet e Madhe, ku akoma nuk po marrin masat për këto gjë, ndërkohe që u la detyrë që të përshpejtohen procedurat për nënshkrimin e kësaj kontrate edhe në rrethet Kukës, Permet, Sarandë dhe Has.

Gjatë diskutimeve u theksua, gjithashtu, se duhet të mbahet parasysh nën të 2/3 të Kontrates Kolektive të nivelit të parë, duke u bërë të ditura problemet edhe DAR dhe ZA, si edhe duke e vënë theksin tek roli që duhet të luajnë kryetaret e seksioneve të qarqeve për këto çështje.

Një tjetër problem shqetësues është ai i grumbullimit të kuotave të anëtarëve. Mendimet për këto probleme ishin të shumta dhe moszbatimi i nenëve 117/2 dhe 181/7/c të Kodit të Punës, ka të bëjë edhe me punën e pamjaftueshme të drejtuesve të seksioneve. Por, në të njëjtën kohë, pati edhe mendime se zgjidhja e këtij problemi mund të lehtësohet shumë, nëse do të bashkëpunohet me mire midis të dy sindikatave të arsimit, për t'u

anëtarësuar të gjithë mesuesit në njërin nga sindikatat, SPASH dhe FSASH.

Kryetari i Seksionit Sindikal të Qarkut të Shkodrës, zoti Aleks Dushi, duke sjellë në Keshill zërin e anëtarëve të kryesise së këtij Qarku, shtroi problemin e minimumit jetik, Statusit të Mesuesit si edhe vazhdimin e kualifikimit të mesuesve dhe decentralizimin e sistemit arsimor, detyra këto që duhet të ndiqen me mirë dhe nga dy kryesite qëndore të SPASH e FSASH.

Gjatë diskutimeve doli që drejtuesit e seksioneve duhet të punojnë me mirë për të propaganduar Kontratën kolektive të të dy niveleve, mbasi mosnjohja e tyre ka sjellë një fitë të disa anëtarëve mbaj sindikates, gjë që duhet të na shqetësojë dhe të mërrëm të gjithë për t'i dhënë fund kësaj gjendjeje.

Në Keshill u ra dakord që, në bazë të një grafiku, të shkohet në bazë, në keshillat sindikale të shkollave, sidomos gjatë periudhës deri në 1 qershor.

U ra dakord, gjithashtu, që mbi bazën e vendimeve të Kongresit të 4-të të SPASH-it, të përgatitet dhe shpërndahet Fletëpalosja e re dhe në Kokejin me rastin e 16 vjetorit të SPASH-it, të shpërndahen Certifikata Mirenjehjeje për aktivistët me të mirë të SPASH-it.

Defrim SPAHIU

Plotesimi me mire i kerkesave te anetareve kerkon konsolidimin e metejshe me te strukturave te FSASH

Nga mbledhja e KD te FSASH

I mbledhur ne fillim te shkurtit, KD FSASH beri analizen e veprimtarise dhe punes se Federates gjate vitit 2006 dhe percaktoi drejtimet kryesore te veprimtarise se saj gjate vitit 2007.

Ne fjalen hyrese qe mbajti kryetari i Federates, zoti Xhafer Ddaushi, midis te tjerave, theksoi:

Gjate vitit 2006 Federata jone u perball me dy sfida te madha: Se pari, rritja e pagave per gjithe sistemin parauniversitar dhe, se dyti, negociimi dhe nenshkrimi i Kontrates se re Kolektive te Punes.

Ne periudhen janar- prill 2006 marredheniet dhe bisedimet midis FSASH, nga njera ane dhe Ministrise se Arsimit e Shkences dhe Qeverise, nga ana tjetere, per problemin e mases se rritjes se pagave per vitin 2006, kane qene intensive dhe ne disa momente te tensionuara. Kjo ndodhi per shkak se Qeveria dhe MASH, pa u konsultuar me partneret sociale shpallen se do te rritnin pagat per arsimin parauniversitar ne mases 27 ose 28 perqind, duke perfshire ne pagen mujore te rritur edhe pagen e 13-te. Ne e konsideruam si spekulim politik pretendimin se pagat gjoja po rriteshin 27 ose 28 perqind, per shkak se ne kete rritje perfshihet edhe 1/ 12 e pages se 13-te, me nje efekt mujor prej 8.3 perqind, shperblim te cilin mesuesit e merren qe nga viti 1999.

Ne keto kushte, FSASH i kerkoi

Qeverise qe te pranonte publikisht se

pagat ne sistemin e arsimit parauniversitar, duke filluar nga 1 korrik 2006 do te rriteshin mesatarisht 20 perqind. Po kete rritje do te pesonte edhe paga e 13-te, perpara se ajo te shperndahej ne pagen mujore.

Po keshtu FSASH u shpreh absolutisht kunder diferencimit ne page per mesuesit e matematikes, informatikes dhe fizikes.

Prantimi per nje shperblim vjetor ne fund te vitit te barabarte me 10.000 leke te konkretizohet me VKM.

Me plotesimin e dy nga keto tri kushte te parashtruara, FSASH shpalli ndezprerjen e veprimeve sindikale dhe keshtu, u hap rruge per negociimin per Kontraten e re Kolektive te Punes. Ky negociim ishte nje proces qe ne nivelet teknike midis sindikatave dhe MASH zgjati pothuajse 3 muaj. Me 4 korrik 2006, midis Ministris Pollo dhe perfaqesuesve te sindikatave te arsimit u nenshkrua Kontrata e re Kolektive. E rendesishme eshte se ne kete Kontrate, qe i shtrire efektet deri me 31 dhjetor 2009, u nenshtet po ato standarde qe pembanin kontratat e mepareshme dhe ne disa drejtime u avancuan ato, sic eshte rasti per lirin dhe te drejtat sindikale, per emerimet, largimin dhe levizjet ne pure, etj.

Cilat jane disa nga problemet dhe

shqetesimet me te cilat ne do te perballlemi ne te ardhmen sidomos gjate ketij viti.

Para se gjithash, nga MASH duhen filluar procedurat per zbatimin e kerkesave te nenit 8 pika 7, shkronjat "a" dhe "b" te Kontrates Kolektive, ku Ministria e Arsimit dhe Shkences ka mase persiper detyrimin qe t'i propozoj Qeverise qe ne VKM Nr .194, date 22.04.1999 te behen keto shtesa:

"a. Ne lichen nr .1 "Struktura e pages per vjetersi mesimore " qe i bashkangjitet ketij vendimi, ne kolonen "shtesa per vjetersi ne pure", shtesa prej 2 perqind ne vit te jete per vjetersi ne pure dhe jo per vjetersi ne profesion, duke shfuqizuar piken (2) II te VKM Nr . 194 date 22.04.1999.

b. Ne kolonen "shtesa per kualifikim", te po kesaj lichenje te shtohet nje element i katert per ata mesues qe kane mbi 25 vjet vjetersi pure, te cilet shtesen per kualifikim duhet ta perfitojne jo 20 perqind sic eshte sot, por 25 perqind".

Po keshtu sindikatat e arsimit, ne bashkepunim me MASH, duke iu referuar nenit 8, pika 8 shkronja "a" te kontrates kolektive, duhet t'i japin hapsire idese se shperblimit te mesuesve kur ndodhen para kerkeses per nevoja madhore ne arsim, duke hartuar per kete kuadrin ligjor per kates.

Ka ardhur koha, dhe kjo nuk

Vijon nga faqja 7

pret me, per te intensifikuar përpjekjet per hartimin e draftit per Statusin e Mesuesit.

Vitin qe shkoi jane shfaqur raste te shkeljes flagrante te dispozitave te Kontrates Kolektive per marrdheniet e punes, per emerimet ne pune, ndryshimin e vendit te punes dhe largimet nga puna.

Tipike jane veprimet qe kane ndemare ZA ne Permet, Devoll dhe Pogradec, titullaret e te cilave, ne kundërshtim me dispozitat e KK te nivelit te pare, si dhe me Udhëzimin e Ministririt te Arsimit dhe te Shkences Nr. 29 date 18 shtator 2006 "Per emerimet dhe levizjet e personelit mesimor dhe drejtues ne arsimin parauniversitar " kane larguar nga puna dhjetra mesues.

Edhe mbas nderhyrjes sone energjike prane ketyre Zyrave Arsimore dhe prane Ministririt te Arsimit dhe Shkences ceshtja nuk eshte zgjidhur .

Tani Kryesise se FSASH i ka mbetur vetem rruge gjyqesore e mbrojtjes se ketyre mesuesve. FSASH do te kembengul, duke u mbeshtetur ne kuadrin ligjor perkates qe drejtuesit e ketyre ZA te ndeshken per veprimet e tyre haptazi antiligjore dhe per te vene ne vend te drejtat e shkelura te mesuesve antare te sindikates sone.

Ne vijim zoti Xhafer Dobrushti u ndale tek disa nga drejtimet dhe objektivat kryesore te FSASH-it per vitin 2007.

Persa i perket forcimit te kapaciteteve te Seksioneve Sindikale ne qarqe e rrethe ka arritje dhe po fitohet qendruesmeri. Kjo duket ne stabilizimin e antaresise dhe ne zgjerimin e problematikes

sindikale ne disa seksione si Tirana, Fieri, Vlora, Durresi, Kucova, Mallakastrë, Devolli, Skrapari, Kukesi, Kolonja, e ndonje tjeter. Pretojne per nje ndryshim pozitiv te veprimtarise sindikale disa seksione si Dibra, Librazhdi, Pogradeci Kurbini, Permeti, Tepelena , Berati dhe Mati.

Per kete vit, Kryesia e FSASH duhet te ndihmoje per te kapercyer gjendjen e sotme disa seksione sindikale me peshe si Shkodra, Korca dhe Elbasani, te cilat vitin e kaluar , jo vetem qe nuk ruajten qendruesmeri dhe nuk bene asnje hap perpara, por perkundrazi, jane kthyer prapa.

Po keshtu, Kryesia duhet te punoje me mire dhe te ndihmoje nga afer disa seksione per t'i riorganizuar ato, sic jane Lushnja, Gramshi, Rika dhe Kruja.

Duke perfitur nga programi per fuqizimin e sindikatave te arsimit ne Shqiperi, program qe, sic e dini, eshte mundesuar me ndihmen financiare dhe trajnuese te Sindikates Holandeze te Arsimit, ne vitin qe shkoi u be nje pune e vleresueshme trajnuese dhe organizuese me grate dhe te rinjte ne Federate. Tani ne kemi hedhur nje baze te mire me komisionet e guas e te rinise dhe kete vit jane te gjitha mundesite qe keto komisione te konsolidohen me tej atje ku ekzistojne dhe te ngrihen komisionet ne rrethet ku programi deri tani nuk ishte fokusuar .

FSASH se bashku me SPASH ka zhvilluar dhe po zhvillon nje veprimtari masive dhe cilesore me famijet qe punojne ne ruge, qe jane kontigjente per ta braktisur shkollen ose e kane braktisur ate.

Me ndihmen e programit nga FNV dhe AOb, qe cituam me sipër , jane mundesuar dhjetra aktivitete trajnuese e sensibilizuese, me mesues, nxenes, prinder dhe aktore te tjere, perfshire punedhensit, organe te pushtetit vendor , forcave te rendit, sidomos ne disa rrethe si Tirana, Fieri, Shkodra, Elbasani e ndonje tjeter . Kjo ka bere qe FSASH, se bashku me sindikaten tjeter te arsimit, SPASH, te konsiderohen sot si sindikatat me te dalluara per efektivitet dhe cilesi ne parandalimin e punes se femijeve dhe kthimin e tyre ne skolle.

Ne do ta vazhdojme edhe kete vit, si dhe ne vitet e ardhme, kete veprimtari, sepse tani kemi hedhur , jo vetem nje baze te shprehur, por kemi edhe nje vizion me te qarte per ate qe do te bejme ne te ardhmen.

Disa nga synimet e FSASH per vitin 2007 do te jene:

Se pari , do te synojme te forcojme e fuqizojme me tej te gjitha strukturat perberese te Federates , perfshire keshillat sindikale dhe seksionet sindikale ne te gjithë vendin. Bazen e ketij fuqizimi e perben konsolidimi i antaresise, qendruesmeria e saj, konceptimi me i plote nga ana e cdo sindikalisti te te drejtave qe ai fiton, te rolit qe luan dhe te pergjegjesive qe merr persiper kur antareschet ne sindikate.

Ky pozicionim nuk i pranon me praktikat e vjeteruara te derisotme, kur shpesh here nje keshille apo seksion sindikal, apo edhe vete Federata para disa viteve mjaftcheshin me lista simpatizantesh, mbeshtetsish te perkcheshem, qe krijonin numra te medhej, por qe ne momente vendimtare nuk perbenin

nje force te vertete dhe te qendrueshme sindikale. Se dyti, ne kuadrin e fuqizimit te strukturave sindikale, te funksionimit te tyre statutor,

Kryesia dhe Keshilli Drejtues do ta vene theksin ne forcimin e konsolidimin e komisioneve te gruas dhe te rinise, per t'i përfshire dhe angazhuar keto kategori anetaresh ne problematika qe ata i preokupojne, per t'u dhene atyre vendin qe meritojne ne te gjitha strukturat drejtuese te Federates, per te sjelle nje fryme te re me dinamike ne levizjen sindikale ne arsim, per te emancipuar keshillat dhe seksionet sindikale, duke rritur forcen argumentuese dhe objektiviteten e kerkesave qe ato shtrrojne dhe duke gjallëruar dialogun social.

Se treti, ne do ta zgjerojne e thellojne punen e nisur, nbi bazen e pervojës se fituar, per t'i tehsqur femijet nga puna e muges, per t'i kthyer ne skolle nxenesit qe e kane braktisur ate, per t'u dhene nje shans te dyte atyre femijëve e te rinjëve qe mund e duhet te integrohen me dinjitet ne shqopri. Ne keto veprimtari ne kemi pasur dhe kemi mbeshtetjen e Federates Boterore te Arsimit, EI, te Sindikatave Holandeze, AOb e FNV, te institucioneve qe veprojne ne Shqiperi dhe qe merren me punen e femijëve, siceshte ILO-IPEC, etj.

Se katerti, FSASH do te beje përpjekje te vazhdueshme per rritjen e pagave dhe pemi-resimin e sistemit te shperblimeve, duke mundësuar qe, se bashku me MASH, te hartoje e dergoje ne Qeveri kuadrin e nevojshem ligjor per vjetersine ne pune, per rritjen me 5 perqind te sistemit te sotem te kualifikimit te mesuesve, per Statusin e Mesuesit

dhe per ndertimin e nje sistemi motivues shperblimi per nevoja madhore ne arsim.

Se pesti, FSASH do te studjoje e praktikojte qe kete vit kryerjen e shërbimeve e perfitimeve te caktuara per anetaret e vet. Përvëc shperblimit qe aplikohet sot deri ne masen e dy pagave mujore per mesuesit anetare te sindikates qe dalin ne pension, po shqyrtohen edhe perfitime te tjera te mundeshme qe do te kene sindikalistet nga antaresimi ne sindikate.

Ne vijim, Sekretari i Pergjithem i Federates, Stavri Liko, paraqiti disa konkluzione mbi aktivitetin financiar te Federates (te ardhurat dhe shpenzimet) per vitin 2006 dhe projektin e buxhetit te saj per vitin 2007.

Pasi paraqiti shifrat ne lidhje me te ardhura dhe shpenzimet, ai vuri ne dukje se bilanci financiar i vitit 2006 ka tregues te afert dhe pothuajse te njejtat karakteristika si ai i ketyre dy tre viteve te fundit, megjithe disa veshtiresi qe jane vere re gjate ketij viti, sidomos per shkak te situatave sociale me shume probleme.

Duke u ndalur tek te ardhurat, ai vuri ne dukje se burimi pothuajse i vetem per te perballuar aktivitetin e Federates gjate vitit 2006 kane qone te ardhurat nga kuotat, te cilat kane qone pothuajse ne te njejtin nivel si ai i ketyre 2-3 viteve te fundit.

Peshan kryesore ne realizimin e ketyre te ardhurave vazhdojne ta mbajne rrethet qe kane krijuar nje tradite tashme ne grumbullimin e te ardhurave nga kuotat si: Tirana Qytet, Vlora, Fieri, Durresi, Kuçova, Skrapari, Mallakastra, Devolli etj.

Rrethet Kavaje, Kolonje, Mirdite

kane shifra relativisht te ulta, ndërsa rrethe te rëndësishme si Shkodra, Tirana rreth, Elbasani, Berat kane shifra qe nuk mund te justifikohen, duke pare potencialin dhe mundësite qe ato kane.

Problemi per vitin 2006 kane qone rrethet Bulqize, Gjirokastrë, Korçe dhe Pëmet, te cilat nuk kane asnje leke kuota, ndërkohë qe ne vitet e mëparshme kane qone mire ose relativisht mire, ndërsa vazhdojne te kemi probleme ne rrethet e Krujes, Lushnje, Hasit, Delvines, Pëqinit, ku akoma nuk kemi strukturat perkatese te Federates.

Per vitin 2007 duhet nje angazhim serioz nga secili prej nesh, per te bere nje kthesë rrenjesore ne kete drejtim, sidomos ne ato rrethe ku niveli i te ardhurave nga kuotat vazhdon te jete i ulet ose keto te ardhura mungojne fare, megjithe potencialin e madh qe ato kane.

Pemi-resimi i gjendjes ne kete drejtim eshte nje kerkese e drejtperdrejte edhe nga ana e EI dhe partnereve te tjere ndërkombetar, si ata holandeze etj, te cilet gjate kontakteve qe kemi patur keto kohen e fundit kane kerkuar qe ne te shmangim termin anetare te rregjistruar dhe, kur llogarisim anetaret, te kuptojme vetem ata qe paguajne kuoten e antaresise.

Per kete ne duhet te punojme ne dy drejtime: e para, te shohim mundësinë e rritjes graduale te masës se kuotes nga afersisht 0.3 perqind qe jemi aktualisht, te pakten ne masen 0.35 perqind te pages per vitin 2007, qe do te thote rreth 60-70 leke ne muaj dhe me nje rritje

Vijn nga faqja 9

tjetër graduale gjate vitit 2008, për të shkuar në vitin 2009 tek masa statutore që ne kemi miratuar në Kongres, prej 0.5 përqind të pages.

Shërbujt me të mirë edhe brenda seksioneve tëra sindikale tregojnë se me punë me këmbëngulësi në mund t'i arrijnë këto nivele.

Duke u ndalur tek treguesit e shpenzimeve, ai theksoi se ato edhe gjate vitit 2006 vlerësohen si normale dhe të domosdoshme për një aktivitet të gjatë sic është ai i Federatës së re, ku vendin kryesor e zënë shpenzimet për aktivitetet sindikale dhe veprimtarinë normale të strukturave të Federatës, financimet për seksionet në rrethë, pagat dhe disa shpenzime administrative.

Administrimi i të ardhurave e shpenzimeve është bërë konformë të gjitha rregullave financiare, duke qenë gjithçka e dokumentuar dhe e kompjuterizuar, sipas kërkesave të kësaj dhe të gjitha dokumentacionet janë të hapura për secilin, jo vetëm si tabela, por edhe dokumentacioni tjetër i të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në mbledhje u bënë diskutime të shkurtra nga anëtarët e Keshillit Drejtues, kryetarë të seksioneve në rrethë. Kryetarët e Seksioneve sindikale të Elbasanit, Leonard Çarçani; Mirdites, Xhovalin Gjiraj; Kavajës, Muharrem Shqarri, vlerësuan kontratën kolektive të nivelit të parë dhe theksuan domosdoshmerinë e nënshkrimit dhe zbatimit të kontratës së nivelit të dytë me Drejtoritë Arsimore përkatëse. Ata theksuan, gjithashtu, problemet që kanë lindur në lidhje me pushimet dhe transferimet e disa mesuesve, të cilat janë bërë mbi baza të qëndrimeve politike dhe në

kundërshtim me kontratën kolektive. Problemet të kësaj natyre ngriti edhe Kryetari i seksionit sindikale të Pogradecit, Istref Haxhillari. Kryetari i seksionit sindikal të Skraparit, Perparim Musabelliu, pasi vuri në dukje pemirosimet që janë në këtë seksion gjatë këtyre viteve të fundit, si rezultat i punës konkrete që është bërë nga ky seksion në shkollë, theksoi domosdoshmerinë e ndryshimit të konceptit në lidhje me anëtarët, duke i konsideruar të tillë vetëm ata që zbatojnë detyrimet statutore, përfshirë edhe pagesën e kuotizimit të anëtarëve, ndërkohë që kryesia e Federatës duhet të këmbëngulë për të kthyer në vendime qeverie ato nënë të kontratës kolektive që kanë të bëjnë me disa shërbime të tjera për anëtarët. Kryetari i Seksionit të Kurbinit, Filip Rajta foli me optimizëm përpara për të gjendjes se këtij seksioni, bazuar edhe në arritjet që janë shëruar gjatë këtyre pak muajve të fundit, ndërsa kryetari i seksionit të Gjirokastrës, Skender Skenderi, pranoi përgjegjësinë për gjendjen aktuale dhe u zotua për ndryshim pozitiv të saj gjatë vitit në vazhdim.

Zv/Kryetari i Federatës dhe kryetar i seksionit të Vlores, Petref Çelaj, vlerësoi planin e kryesisë së Federatës për organizimin e takimeve me përfaqësues të bashkive e komunave dhe shprehur angazhimin për rezultate më të mira në të ardhmen.

Pasi miratoi raportin për buxhetin e vitit 2006 dhe projekt buxhetin për vitin 2007, Keshilli Drejtues i Federatës u ndalë tek një çështje që po bëhet gjithnjë e më shqetësuese

dhe që ka të bëjë me situatën në Konfederatë dhe marrëdhëniet e FSASH-it me të. Pas një diskutimi shumë serioz në Kryesi, në emër të saj, Kryetari Federatës, Xhafer Dobushi, informoi Keshillin në lidhje me problemin kryesor që na preokupon aktualisht, duke vënë që në fillim në dukje se ndërkohë që priteshin pemirosime gjatë këtyre dy viteve të fundit, pas Kongresit të KSSH, situata ka ardhur duke u përkeqësuar përpjetë në të gjitha drejtimet. Shumë shqetësuese është gjendja në lidhje me zbatimin e Statutit të KSSH, ku vihen re shmangie edhe nga parimet themelore të funksionimit të kësaj bashkësie. Ndër të tjera, ai theksoi se janë krijuar shumë probleme në drejtim të funksionimit të strukturave të KSSH dhe të disa Federatave, gjë që ka një ndikim të drejtpërdrejtë edhe tek Federata jonë. Akoma me shqetësuese janë problemet e administrimit të pasurive të Konfederatës ku në duhet të kemi pjesën kryesore, për shkak të peshës që zë Federata jonë, sipas numrit të anëtarëve, por ndërkohë që federatave u është hequr fare financimi, administrata e KSSH vazhdon të veprojë në kushte komode, me shpenzime që nuk mund të justifikohen. Pas diskutimeve të shkurtra në lidhje me këtë çështje, Keshilli Drejtues miratoi një Kërkesë që do të paraqitet në mbledhjen e keshillit Drejtues të KSSH.

Në përfundim, Keshilli Drejtues miratoi edhe një ndryshim në përfaqësimin e FSASH në Komisionin e Kontrollit dhe Revizionimit të Konfederatës.

A Do tA thYeJ e heShtj eN MASH?

Me qene se qe nga koha e dergimit te Letres qe vijon ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences ka kaluar me shume se nje muaj dhe FSASH nuk ka marre asnje pergjigje per masat qe jane marre per venien para pergjegjesise te drejtuesve te ZA qe shkelin ligjin dhe KK te Punes, Redaksia vendosi ta beje publike kete Lete per qoninionin sindikalist e me gjere dhe, ribeshtetur ne pervojat pozitive, konkrete e institucionale qe deri me sot eshte ndertuar e zbatuar ne marrredheniet midis MASH e FSASH, shpreson se Ministria e Arsimit dhe Shkences, duke heshtur, nuk ka ndemend te marre ne ndrojtje shkelsit e ligjit, te KK te Punes dhe te Udhezimeve qe ka nxjerre Ministri i Arsimit dhe Shkences per kriteret e levizjeve ne pune dhe largimeve nga puna.

MINISTRIT TE ARSIMIT
DHE SHKENCES
Z. GENC POLLO

Z. Minister,

Ju vene ne dijeni se Drejtori i Zyres Arsimore te Rrethit Pemet, z. Kujtim Muratllari, me vendimin nr .7 date 05.03.2007, ka urdhenuar transferimin e Kryetarit te Seksionit

Sindikali te FSASH per Rrethin e Pemetit, z. Saliko Hob nga Shkolla e Mesme e Pergjithsme " Sami Frasheri" ne qytetin e Pemetit ne Shkollen 9 vjecare " K.Benja"

Kelcyre, me motivacionin "per forcim te punes edukative".

Ne nje hark kohor prej 13 muajsh, nga 06.02.2006 deri me 05.03.2007, z. Kujtim Muratllari, me autoritetin e Drejtorit te ZA, ka levizur 5 here Kryetarin e Seksionit Sindikal te FSASH z. Saliko Hob dhe kerketist:

1 Me 5 shkurt 2006, me vendimin nr . 5, eka larguar z. Hob nga detyra e inspektorit ne Zyren Arsimore dhe e ka komanduar ne Shkollen e Mesme te Bashkuar Suke.

2 Me 14 qershor 2006, 2 dite para nbylljes se vitit shkollor, me urdher verbal e largon nga puna ne kete shkolle dhe i jep vetenditet e lejes qe i takonin.

3 Me 31 korrik 2006, me vendimin nr . 16, e emron kryeresues ne Shkollen Topojan, 40 minuta me autobus dhe pastaj 2 ore ne karbe larg nga qyteti i Pemetit.

4 Me 31 gusht 2006, me vendimin nr . 17 e komandon si psikolog ne Shkollen e Mesme " S. Frasheri" Pemet.

5 Dhe se fundi, me 5 mars 2007, e transferon nga qyteti i Pemetit dhe e

emron Mesues ne Shkollen 9 Vjecare " K. Benja" Kelcyre, per te mbuluar problemet edukative edhe ne shkollat e komunave Dishnice, Suke e Ballaban.

Te gjitha keto levizje qe i ndryshojne vendin e punes mesuesit Saliko Hob, i cili eshte i zgjedhur Kryetar i Seksionit Sindikal te FSASH per Pemetin, jane ne kundrshtim flagrant me Nenin 181 pika 5 te ligjit nr . 7961 date 12.7.1995, ndryshuar me ligjin nr . 8085 date 13.3.1996 dhe ligjin nr . 9125 date 29.7.2003 " Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise"; me nenin 13 pika 3 te Kontrates Kolektive te Punes dhe me Udhezimin nr .29 date 18 shtator 2006 te Ministrimit te Arsimit dhe Shkences.

Mesuesi Saliko Hob ka mbaruar arsimin e larte dhe eshte diplomuar per gjithe letersi shqipe, ka kryer specializimin njevjecar pasuniversitar per pedagogji-psikologji dhe njestazh pune prej 28 vjetesh pashkeputje nga puna me neresit.

Vepimet haptazi antiligjore qe ka ndemarre Drejtori i Zyres Arsimore Pemet kundrejt nje mesuesi me reputacion dhe mandat sindikal, sic eshte z. Saliko Hob, jane nje mosperfillje dhe neperkenbje e kuadrit ligjor te marrredhenie te punes ne shtetin tone demokratik dhe ato nuk mund te kene asnje justifikim tjetër pervec qellimit te urdherdhenesit per te ndeshkuar kete mesues per shkak te bindjeve te tij politike dhe vepintarise sindikale. Nje vepintari e tille eshte e denueshme administrativisht me gjobe nga neni 146, pika 1, shkronja " c " dhe " e " te Kodit te Punes dhe dendet si krim nga neni 253 i Kodit Penal.

Z. Minister,

Ne zbatim te ligjit dhe te marrredhenie kontraktuale dypaleshe, kerkojme nga Ju qe Drejtori i Zyres Arsimore Pemet, z. Kujtim Muratllari, per shkeljet e renda qe ka kryer, te vinit para pergjegjesise administrative dhe te ndeshkhet si shkeles i kuadrit ligjor te marrredhenie te punes dhe njekohesisht te detyrhet ZA Pemet qe te ktheje ne vendin e neqaresham te punes Kryetarin e Seksionit Sindikal te FSASH ne Pemet, z. Saliko Hob

Kerkojme, gjithashtu, qe nje qendrim i tille te ndalet edhe ndaj Drejtoreve te ZA Pogradec e Devoll, te cilet, sic ju kemi vene ne dijeni, kane kryer veprime analoge antiligjore duke larguar nga puna ne menyre arbitrare dhe tjera mesues, te cilet duhet te kthehen ne pune dhe t'u paguhet dani i shkaktuar.

Ne vartesi te zgjidhjes se ketyre shkeljeve te renda dhe rivendosjes se te drejtave te anetareve dhe drejtuesve sindikale te FSASH ne rrethet Pemet, Pogradec dhe Devoll,

FSASH rezervon te drejten t'i drejtohet Gjykates, ku do te kerkoje zbatimin e nenit 146 pika 1, shkronja "c" dhe "e", si dhe do te beje kallezim per ndjekje penale te ketyre personave bazuar ne nenin 253 te Kodit Penal.

Nje kopje e kesaj letre u eshte derguar edhe Drejtoreve te DAR Gjirokaster e Korce dhe Drejtoreve te Zyrrave Arsimore Pemet, Pogradec e Devoll.

Jemi ne pritje te pergjigjes nga ana jaja.

Me respekt:
Xhafer Dobrushki
Kryetar i FSASH

Nga aktivitetet ne shkollat e Tiranës me rastin e 7 Marsit



Ne Shkollën "Konferenca e Pezes" festimet me rastin e 7 Marsit, Dites se Mesussit, u paraprine nga nje aktivitet shume interesant, me nje pjesemarrje te gjere te nxenesve, te titulluar "Dita e Panairit", ku u ekspozuan punimet e semestrit te pare me tematike: "Te ndryshem, por te barabarte".

Lidhja nderlendore dhe grupimi i nxenesve sipas prirjeve beri qe kjo

veprimtari te kishte lami dhe interesim nga te gjithe nxenesit e shkolles.

Ne syte e secilit fotografimi ishte i shpejte dhe perfetyrimi ecte larg, ku shfaqej brezi i ardhshem qe synon te sjelle ndryshime ne shkollë, ne edukimin global per sfidat e jetes ne nje shoqëri komplekse te rnderuar dhe ne zhvillim te shpejte.

E prekur nga emocionet, nxenesja

Klea Rozani thote: "Ne jami shume te kenaqur qe ne klasen tone erdhen kaq shume nxenes e mesues te shkolles dhe i pelqyen kaq shume krijimet tone. Ky eshte nje frymëzim per secilin prej nesh per te vazhduar ne kete ruge dhe per te terhequr rreth vetes sa me shume bashkemoshatare, jo vetem ne shkollën tone, por edhe me gjere ne shkollat e tjera".



PERKUJTOHET 40 VJETORI I GAZETES "STUDENTI"

Historia perseritet edhe pas 40 vjetve. Atehere, me 2 Mars 1967 ajo do te ishte i pari organ shtypi me synimin per te qene "Zeri i studenteve". E lindur nga inisiativa personale e disa studenteve te atehereshem si Xhafer Dobrushii, Xhevahir Spahiu, Faik Ballanca, Zhuliana Jorganxhi, Spiro Dede, Pellumb Kallfa, Ndue Ukcama, etj, kjo gazete u shnderrua brenda pak kohesh ne organin studentor me te devotshem. U be i pari organ informues per studentet atehere kur ndihj nevoja per nje te tille.

E fokusuar me teper ne problemet qe prektonin studentet, per te cilat diskutonin, jo vetem midis tyre, por edhe ne fakultete, "Studenti" ishte zeri dhe pasqyrimi i se vertetes per kohen, natyrisht brenda kufirit te asaj kthe.

E perdyjveshme, vetem me 4 faqe dhe me nje tirazh prej 4000 kopjesh "Studenti" shpernduhej falas ne aubjantet universitare te te gjitha fakulteteve te Universitetit te Tiranes, te Universitetit Bujqesor, te Institutet e atehereshme te Arteve e Fizikures dhe ne Institutin Pedagogjik te Shkodres.

Çdo student, por edhe pedagog, sidomos pedagoget e rinj, me shkrimet e tyre, me mendimet dhe sugjerimet e tyre, beheshin pjese e kesaj gazete. Ne "Studenti" kane botuar poezite, fejtoret, skicat dhe reportazhet e tyre te para Zhuljana Jorganxhi e Betim Muro, Xhevahir Spahiu e Spiro Dede, Faik Ballanca e Mehmet Elezi, Ndue Ukcama e Ilia Nikolla, Hysni Milloshi e Gezim Isufi, Renzi Lani e Dillaver Baxhaku, Xhafer Martini e Arian Kadiu, Tonin Shtjefni e Mero Baze, Kudret Isai e Rrapo Zguri, Sokol Terhati e Arben Muka, Ben Blushi e

Blendi Fevziu, Andi Bejtja e Mark Marku, Andi Bushati e Sami Neza, etj. Ne "Studenti" kane botuar shkrimet e tyre te para me teme nga historia, letersia e arkeologjia, matematika, drejtesia apo mjekesia pedagoget e rinj dhe miq te studenteve si Aleko Minga, Sali Berisha, Nexhip Gami, Gramoz Hysi, Muzafer Xhaxhiu, Gjergji Minga, etj.

Xhafer Dobrushii eshte emri i pare

reflektonin emrione talentesh. Me pranire e tyre ata te jepnin force e besim, ta lehtesonin punen dhe lodhjen. Edhe pse do te diplomoheshin per drejtessi, me tehiqte fort gazetaria, sepse megjithese ato jane dy profesione e degje te ndryshme, kane dicka thelbesore te perbashket: zbulimin e pasqyrimin e se vertetes dhe ndertimin e drejtesses nbi kete te vertete."



Redaksia e gazetës "Studenti" në hekurudhë,
Gradishtë, qershor 1967

me te cilin kujtohet vigjilja e kesaj gazete. Nje student i vitit te dyte te Fakultetit te Shkencave Politike Juridike u be kryeredaktori i pare i "Studentit", ose sic quhej me humor nga koleget studente te redaksise " i pari midis te barabarteve", shprehje qe studentet e deges se drejtesses e mesonin nga e Drejta Romake.

"Edhe sot rinas 40 vjetesh e kujtoj me impresion e nostalgji ditën e pare te punes sime si kryeredaktor vullnetar, impenjimin per te nxjerre ne drite numrin e pare, i rrethuar nga ata djem e vajza te reja, qe ndosne ishin ne hapet e pare te krijimitarise se tyre,

"Studenti" i 40 viteve me pare dhe i gjitha kthes qe ai nbi jetoi eshte nje copez e jetes se studenteve te nje periudhe te aktuar historike. Ai nbarnt vlerat e mira qe solli dhe ddbesite qe nuk mundi e nuk mund t'i menjanonte. Si cob ngjarje e fenomen, edhe ai mund te gjykohet. Por mesimi qe mund te nxjerrim duke perkujtuar e festuar kete 40 vjetor, nuk eshte vetem respekti per kikat e "bardha" te atyre qe e krijuan dhe e bene pothuaj 40 vjec, por edhe nenvizimi i nevojës e mundesise qe studentet mund e duhet te kene nje organ te tyre, nje "Student" te ri.

Krijohet Keshilli i Sindikatave Globale

Sekretari i Pergjithshem i EIL, z. Fred van Leeuwen zgjidhet Kryetar i Keshillit

Pak kohe pas themelimit te Konfederates Nderkombetare te Sindikatave, ITUC, (qe erdhi si bashkim i Konfederates Nderkombetare te Sindikatave te Lira, ICFTU, me Konfederaten Boterore te Punes, WCL, ne nentor 2006), u krijua Keshilli i Sindikatave Globale.

Te mbledhur ne Bruksel, ne daten

punetore dhe familjave te tyre.

Çdo organizate perfaqesohet ne Keshill prej tre perfaqesuesve te saj. Kjo iniciative e re synon te krijojë mundesine e nje bashkëpunimi disa dekadash ndermjet organeve sektoriale dhe konfederale ne nivel boteror.

Kryetar i Keshillit u zgjodh,

punonjeseve"

Sekretari i Pergjithshem i Konfederates Boterore te Sindikatave, ITUC, Guy Ryder, vuri ne dukje se "Krypatracitet i ri na jep te gjitha nje platforme te rendesishme per nje solidaritet global te koordinuar, per mobilizim, per organizimin e fushatave dhe mbrotjen e anetareve tane. Ne



9 dhe 10 janar 2007, drejtuesit kryesore te Konfederates Nderkombetare te Sindikatave, OECD dhe Sindikatave Globale te Nderimit, Arsimit, Transportit, Minerave e Energjise, Tekstileve e Veshjeve, Bujqesise e Ushqimit, Sherbimeve Publike, Gazetareve, Tregtise e Bankave, nenshkruan Marrveshjen per themelimin e ketij Keshilli, bazuar ne: "Vendosmerine e perbashket per t'u organizuar, per te nbrojtur te drejtat njerezore e sindikale dhe standardet e punes dhe per te nveshtetur fuqizimin e sindikatave per te mirene e te gjitha grave e burrave

Sekretari i Pergjithshem i Federates Boterore te Arsimit, Fred van Leeuwen.

Ne fjalen e tij, ne kete rast, ai theksoi: "Ky rast historik do te na krijojë mundesine per te perballuar sfidat e jashtezakoneshme ne te cilat ndeshen sistematikisht punonjesit anetare te sindikatave tona, nderkeqe qe secila prej organizatave anetare do te ruaj autonomine e vete. Diskutimet tona ne kuadrin e krijimit te ketij Keshilli kane nxjerre ne dukje mundesite e punes sone te perbashket per te perballuar forcat globale qe punojne kunder interesave te

kami vendosur qe te fillojme menjehere nga puna per tre iniciativa te perbashketa, qe kane te bejne me miratjen e rolit dhe organizimin ne te mire te sindikatave, permiresimin e situates financiare ne kushtete e zhvillimeve te reja te ekonomise boterore dhe permiresimin e sherbimeve publike dhe eliminimin e varferise"

Guy Ryder do te jete Sekretar i ketij Keshilli, ndersa Sekretarja e Pergjitheshme e Federates Nderkombetare te Punonjeseve te Nderimit, Anita Normark, do te jete Zv. Kryetare.

Të reja shkencore

MIAU, POR JO TËSHTIMË

I pëlqeni macet, po hunda juaj? Një kompani në San Diego, (Allerca), po shumon feline, (një lloj maceje), që,



prej natyre, është antialergjike. Shumica e maceve prodhojnë një proteinë në pështymën e tyre që mund të shkaktojë një reaksion alergjik tek njerëzit. Disa

rraca, si Siamezet, prodhojnë më pak se të tjerat. Allerca ka arritur të krijojë një racë mikse macesh tek të cilat proteina që shkakton alergjitë është e fshehur dhe nuk mund të ndihet nga shqisat njerëzore. Allerca teston çdo mace dhe ofron një garanci një vjeçare me të drejtë rikthimi të parave. Kërkesa është e lartë dhe që tani ka një radhë që shkon deri në 15 muaj për kotelet joalergjike, megjithëse çmimi i njërës prej tyre aktualisht është 3,950 USD.

MAKINA LARËSE

Duke marrë parasysh frikën nga pesticidet që mund të qëndrojnë te spinaqi edhe pas larjes, edhe ushqimi më i mirë mund të duket si një rrezik biologjik dhe vetëm larja me fërkim nuk është e mjaftueshme për të larguar bakteriet.

Sistemi Lotus Higjenik, tashmë i gatshëm për t'u futur në perdorim, e kthen ujin e zakonshëm në ujë super të oksigjenuar që vret mikrobet dhe largon toksinat. Makina



përdor një ngarkesë elektrike për të mbushur ujin normal të rubinetit me ozon, në mënyrë që uji të përmbajë një formë oksigjeni që vepron si një pastrues natyral.

Kjo pajisje vlerësohet të kushtojë 200 USD.

NDI ZE MOTORRIN

Çfarë do të bënit nëse bateria e makinës suaj bie gjatë një rrebeshi dhe nuk keni

kavo ose jeni larg një servisi? Me "Nisja e Thjeshtë" të Black & Decker ju mund të viheni përsëri në rrugë pa paguar ndonjë gjë. Karikuesi i baterisë, që mund të merret me vete, vendoset në baterinë 12 voltshe dhe bën që makina juaj të riniset për rreth 10 minuta. Pajisja lëshon një tingull kur bateria e makinës suaj është karikuar dhe drita LED ju lejon të lexoni



ndërkohë që prisni.

Kjo pajisje është e disponueshme që tani me çmimin 60 USD.

Keshilla praktike

SYNIMET PROFESIONALE PËR ÇDO MOSHE

Çdo dhjetvjeçar jete sjell sfida të reja për këdo, si profesionale ashtu edhe personale. Hyrja në një dhjetvjeçar të ri jete mund të jetë momenti i përshtatshëm për të rimenduar gjendjen tuaj aktuale, rivlerësuar prioritetet dhe për të vendosur qëllime të reja për karrierën tuaj për vitet në vazhdim.

Vendosja e qëllimeve i bën njerëzit të ndiejnë që janë në gjendje ta kontrollojnë fatin e tyre, por këshillohet që njerëzit të jenë fleksibël përsa u përket synimeve të tyre.

10 VJEÇ: KINI EKSPERIENCA POZITIVE

Qetësohuni, nuk është e nevojshme që të dini me saktësi që tani se çfarë do të bëni në jetën tuaj. Është e logjikshme që të shqyrtoni mundësitë tuaja në këtë fazë të hershme të jetës suaj profesionale, për aq kohë sa vazhdoni të zhvilloni aftësitë tuaja dhe të krijoni kontaktet e duhura. Vendimi se çfarë do të bëni në të ardhmen është më thelbësor se ç'mund të mendohet nga disa. Është e rëndësishme gjatë këtij dhjetvjeçari të krijohen eksperiencat të reja.

Njerëzit me të cilët punoni në këto vite mund të bëhen mbështetës dhe mësues gjatë të gjithë jetës suaj. Pra, krijimi i një reputacioni të mirë është i rëndësishëm edhe pse nuk e shihni veten në të ardhmen në punën që po bëni aktualisht.

30 VJEÇ: PËRQËNDROHUNI QË TË SHNDRROHENI NË NJË LIDER

Njerëzit shpesh fillojnë në një post si menaxher rreth 30 vjeç dhe kthimi nga të qenit një punonjës i thjeshtë në një profesionist kërkon edhe një ndryshim mentaliteti.

Qëllimi në këtë fazë është të njihet gjithçka keni bërë gjatë rrugës suaj dhe të përdoret për një qëllim më të caktuar. Ilustroni arritjet tuaja në mënyrë që, kur të vijë momenti për raportet vjetore, të keni prova për punën tuaj dhe potencialin si lider.

40 VJEÇ: RIANALIZONI PËRKUFIZIMIN TUJ PËR SUKSES

Në këtë dhjetvjeçar njerëzit bëhen shumë serioz për fuqinë që kanë për të nxjerrë të ardhura dhe për të zënë

pozicione kryesore që mund të jenë të tyre në këtë apo në dhjetvjeçarin tjetër.

Ky është edhe momenti i krizave të mesit të jetës që shpesh karakterizohet nga njerëz që vënë në pikëpyetje karrierën e tyre. Ky dhjetvjeçar është një moment i mirë për të rimenduar drejtimit e karrierës suaj dhe për të vlerësuar jetën tuaj profesionale. Çfarë do t'ju bënte të ndiheshit të suksesshëm? Të keni një pozicion të rëndësishëm në kompaninë tuaj apo në fushën tuaj profesionale? Të arrini potencialet tuaja më të larta për sa u përket të ardhurave? Të keni mundësinë të kaloni më shumë kohë me familjen tuaj? Të dilni në pension më shpejt?

Në bazë të këtyre çështjeve rianalizoni përkufizimin tuaj për sukses dhe përshtasni rrugën që do të ndiqni.

50 VJEÇ: PËRFYTYRONI TË ARDHMEN TUJ

Zakonisht njerëzit janë të mirëvendosur dhe shohin në horizont një pension të mundshëm në këtë periudhë, edhe pse ai është larg, ata

po fillojnë të mendojnë se çfarë duan në të ardhmen.

Krijoni një kalendar të mundshëm për vitet e punës në vazhdim. Nuk ka rëndësi se çfarë shihni në të ardhmen, pensionin, një karrierë të dytë ose më shumë vite në rrugën që keni nisur, është e rëndësishme të jeni të ndërgjegjshëm për kursimet dhe investimet tuaja. Kuptoni vizionin tuaj për të ardhmen dhe sigurohuni që të parashikoni sa më shumë të papritura që të jetë e mundur.

60 VJEÇ (DHE PËRTEJ): KORRNË ATË QË KENI MBJELLË

Ju keni punuar shumë dhe ndoshta nuk keni plane për të pushuar tani. Sido që të jetë rruga e karrierës suaj tani, qëllimi juaj duhet të jetë të shijoni frytet e punës suaj.

Ky është momenti kur shumë njerëz planifikojnë të përfitojnë nga ajo që punonjësit e tyre mund t'u ofrojnë, arsim, udhëtime, të ardhura, çfarëdo që të jenë, është koha për të korrur atë që keni mbjellë.

Përgatiti faqen Erica Vangjeli

Tribuna sindikale

